


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori III, 2024

Tiranë, më 05 Dhjetor: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e tretë të vitit 2024, arriti 108,0 kundrejt vitit 2021 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e tretë 2023, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 1,3 %, një vit më parë ky ndryshim ishte me rritje 0,7 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e tretë 2024, krahasuar me tremujorin e dytë 2024 është ulur me 0,3 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” shënuan ulje me 4,6 %, pasuar nga seksioni “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 93,5 %, i cili shënoi ulje me 1,1 % dhe seksioni “Industri nxjerrëse”, i cili shënoi një ulje me 0,6 %. Nga ana tjetër seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” shënoi një rritje me 0,9 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Konfeksionimi i veshjeve” me 3,8 %, pasuar nga “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 3,5 %, “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 3,2 %, “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilieve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 2,8 %, “Metalurgjia” me 2,1 %, “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,8 %, “Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës” me 1,4 % dhe “Përpunimi i tekstileve” me 1,1 %. Nga ana tjetër çmimet në aktivitetin “Prodhimi i produkteve të duhanit” shënuan rritje me 2,4 %, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” me 2,0 %, “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 0,7 %, “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” me 0,5 %, etj.

Për publikim 05/12/2024

Vijon

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e dytë 2024, çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” shënuan ulje me 1,8 %, pasuar nga seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,7 %, “Industria përpunuese” me 0,3 % dhe “Industria nxjerrëse” me 0,2 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 0,6 %, pasuar nga “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 0,5 %, “Konfeksionimi i veshjeve”, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t” dhe “Prodhimi i mobiljeve” me 0,4 % secili. Çmimet e seksionit “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure”, “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi”, “Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës” dhe “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” me 0,3 % secili.

Tab.1: Indeksi i Çmimeve të Importit

2021=100

NVE Rev2	Përshkrimi	Peshat	07-24	08-24	09-24	III-24
	Gjithsej	100	107,9	107,9	108,0	108,0
B	Industri Nxjerrëse	0,2	111,9	111,9	111,8	111,9
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	111,9	111,9	111,8	111,9
C	Industria Përpunuese	93,5	106,3	106,3	106,3	106,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	112,8	112,8	112,8	112,8
11	Prodhimi i pijeve	3,1	113,5	113,5	113,5	113,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	103,2	103,2	103,2	103,2
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	105,4	105,4	105,4	105,4
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	102,7	102,7	102,7	102,7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	103,9	103,7	103,7	103,8
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	101,2	101,4	101,4	101,4
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	2,3	106,4	106,4	106,3	106,4
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	110,8	110,8	110,8	110,8
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	107,9	107,9	107,8	107,9
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	105,3	105,3	105,2	105,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	100,8	100,8	100,8	100,8
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	4,0	99,2	99,2	99,2	99,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	111,6	111,6	111,6	111,6
24	Metalurgjia	8,6	109,0	109,0	109,0	109,0
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	108,7	108,7	108,7	108,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	106,0	105,9	106,0	106,0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	109,1	109,1	109,2	109,1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	5,5	101,2	101,2	101,2	101,2
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	110,5	110,5	110,5	110,5
31	Prodhimi i mobiljeve	0,8	101,7	101,7	101,7	101,7
32	Industri të tjera p,k,t	2,0	105,5	105,5	105,5	105,5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	142,7	142,7	145,2	143,5
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	142,7	142,7	145,2	143,5
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	108,2	108,0	107,1	107,8
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	108,2	108,0	107,1	107,8

Tab.2: Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

				në %	
NVE	Përshkrimi	Peshat	III- 24 / II- 24	III- 24 / III- 23	
	Gjithsej	100	-0,3	-1,3	
B	Industri Nxjerrëse	0,2	-0,2	-0,6	
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,2	-0,6	
C	Industria Përpunuese	93,5	-0,3	-1,1	
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	-0,5	-1,8	
11	Prodhimi i pijeve	3,1	-0,1	-0,7	
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	-0,1	2,4	
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	-0,1	-1,1	
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	-0,4	-3,8	
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	-0,3	0,5	
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	-0,3	-2,8	
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,3	-0,1	-0,3	
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	-0,1	-3,5	
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	-0,1	-3,2	
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	-0,6	0,1	
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	-0,1	-0,8	
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	-0,3	-1,4	
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	-0,1	-0,6	
24	Metalurgjia	8,6	-0,2	-2,1	
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	-0,3	2,0	
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	-0,1	-0,2	
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	-0,2	0,2	
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	5,5	-0,4	-1,0	
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	-0,1	0,7	
31	Prodhimi i mobilie	0,8	-0,4	0,1	
32	Industri të tjera p,k,t	2,0	-0,1	0,4	
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	-1,8	-4,6	
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	-1,8	-4,6	
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	-0,7	0,9	
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	-0,7	0,9	

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev,2) në nivel 2-shifror,

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.